

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“ TiranaKons 2020” SH.P.K

Sot ne Tirane me date 14/05/2019,

1. **Arjan Pelushi**, atesia Hate, i datelindjes 09.02.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne adresen: Rr.Feti Gjilani, Nr.1, Njesia Bashkiake Nr.6, Tiranë, madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer persona id. G20209127U.

Dhe

2. **Edmond Tahirllari**, atesia Syrja, i datelindjes 27.08.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne Rruga Mine Peza, Pallati nr.250/1, Apt.20, Njesia Bashkiake Nr.9,Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer personal G20827024G.

kane vendosur themelimin e shoqërisë “ **TiranaKons 2020**“ **Sh.P.K**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “ **TiranaKons 2020**” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Shoqëria ka selinë e saj ne adresen: Rruga Feti Gjilani, Nr.1, Njesia Bashkiake Nr.6-Tirane dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**TiranaKons 2020**“ SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqërie do te jete si me poshte :

I. Ne fushen e ndertimit. Punime ndertimi, projektme, prodhim materiale ndertimi, mbikqyrje, kolaudim,etj.

Ndertime civile,industriale, turistike, bujqesore deri ne 5 kate.

Rikonstruksione. Ndertim banese me skelet mbi 8 kate.

Ndertim rruge kategoria IV dhe V.

Ndertim rruge kategoria III-II-I.

Punime te mirembajtjes dhe sinalizimit ne rruge,ndertim mbi shtresa rrugore.

Ndertim, ujesjelles-kanalizime,kanale, impiante vaditese.

Perforcime themeli e punime nentokesore. Izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat.
Ndertim rruges dhe urash si dhe ndertime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim.
Ndertim vepra kullimi, ujitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe siteme hidraulike, punime dhe sitemime elektrike.
Ndertim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte.
Prodhim materiale inerte. Prodhim elemente betoni e b/arme te zakonshme-pararendur, gure dekorative.

II. Tregtimi i lendeve te para import eksport tregtim me shumice e pakice te materialeve te ndryshme ndertimore. Prodhimi i ketyre materialeve dhe mallrave dhe tregtimin e tyre, i pjeseve te tyre te kembimit, brenda dhe jashte vendit.

III. Veprimtari ne fushen e pasurive te paluajtshme, blerjes shitjes ndermjetesimit investimit dhe zhvillimit te tyre.

IV. Tregtimi me shumice e pakice dhe import-eksport i mallrave dhe materialeve te ndryshme, industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, makineri e pajisje te ndryshme, pajisje ndertimi, pajisje elektrike edhe elektronike, pajisje hidraulike, hidrosanitare, elektrike, materiale ndertimi, mallra te te gjitha llojeve.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës ne adresen: Rruga Feti Gjilani, Nr.1, Njesia Bashkiake Nr.6-Tirane, Shqiperi.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete i perbere nga kontributi i ortakeve themelues te kësaj Shoqerie ne para ne vleren **100.000 (njëqind mije) leke.**
Kapitali eshte i ndare ne keto raporte.

Ortaku Themelues:

Arjan Pelushi, zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhjetë mije) lekë qe përben 50 % te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

Ortaku Themelues:

Edmond Tahirllari, zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhjetë mije) lekë qe përben 50 % te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor mbi 10 vjet .
Afati i aktivitet fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në QKR .
Aktivitete tregtare mbyllen në datën 31 dhjetor të çdo viti.
Aktiviteti i parë tregtar do të mbyllet në datën 31 dhjetor 2019 .



NENI 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve
2. Administratori

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë do të jete Z.Arjan Pelushi, i datëlindjes 09.02.1962, lindur ne Tirane, banues në adresen Rruga Feti Gjilani, Nr.1, Njesia Bashkiake Nr.6-Tirane.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori , i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm .

Kur administrimi i shoqërisë mund ti besohet disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhvendosin Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaket e Shoqërisë , në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.


NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt i Themelimit hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga Ortaket Themelues e cilet e gjeten atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan pa vërejtje me vullnet te plote.

ORTAKET THEMELUES:

1. Arjan Pelushi


2. Edmond Tokolli


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DEGA VENDORE TIRANË
NOTERE LEDINA MALAJ**

Nr.REP. 1840

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot ne Tirane me date 14.05.2019, para meje Noteres Ledina Malaj, Anetare e Dhomes se Notereve Tirane, ne studion time noteriale ne adrese: “Bulevardi Zhan d’Ark”, prane Gjykates se Apelit Tirane u paraqiten personalisht:

- 1. Arjan Pelushi**, atesia Hate, i datelindjes 09.02.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne adresen: Rr.Feti Gjilani, Nr.1, Njesia Bashkiake Nr.6, Tiranë, madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me numer persona id. G20209127U.
- 2. Edmond Tahirllari**, atesia Syrja, i datelindjes 27.08.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne Rruga Mine Peza, Pallati nr.250/1, Apt.20, Njesia Bashkiake Nr.9,Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me numer personal G20827024G.

Te paraqiturit madhor me zotesi te plote per te vepruar deklarojne se kane nenshkuar personalisht Statutin dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise “**TiranaKons 2020**” shpk.

Une noterja vertetoj nenshkrimet e tyre si te rregullta ne baze te ligjit.

NOTERE

LEDINA MALAJ

